

Përmbledhëse e ecurisë së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura deri më datë 31.12.2015

Në kuadër të zbatimit të VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar", për vitin 2015 Ministria e Financave ka vijuar punën për të siguruar vazhdimin e procesit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.

Në kuadër të strategjisë, deri më datë 31 dhjetor 2015, Ministria e Financave ka alokuar në total rreth **18.38** miliardë lekë detyrime të prapambetura sipas kategorive: (i) *investimet publike*, janë alokuar **6.31** miliardë lekë, (ii) *shpenzimeve korrente për mallra dhe shërbime*, janë alokuar rreth **0.96** miliardë lekë, (iii) *rimbursim TVSh-je, Tatim-Fitimi dhe Akcize* janë alokuar rreth **5.87** miliardë lekë, (iv) "*Të tjera*" janë alokuar **5.23** miliardë lekë ku përfshihen: detyrimet për "*Vendimet gjyqësore*", janë alokuar rreth **3.75** miliardë lekë, "*Shpronësimet*" janë alokuar rreth **0.27** miliardë lekë dhe "*Emergjencat dhe shpërblimet për lindjet*" janë alokuar rreth **1.21** miliardë lekë.

Në mënyrë të përmbledhur gjeni më poshtë tabelën e alokimit dhe realizimit të pagesave.

			/lekë	
Nr.	Detyrimet sipas kategorive	Vlera e çelur deri më 31.12.2015	Paguar deri më datë 31.12.2015	% paguar/çelur
1	Kategoria e Investimeve Publike	6,307,408,327	6,113,835,546	97%
2	Detyrimet për kontrata për mallra dhe shërbime	962,275,693	844,472,248	88%
3	Rimbursimi i TVSH dhe Tatim fitimit dhe Akcize	5,878,572,966	5,665,762,284	96%
4	Kategoria të tjera (vendimet gjyqësore, shpronësimet, PAK, etj)	5,234,131,777	5,053,664,406	97%
	TOTALI	18,382,388,762	17,677,734,485	96%